Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperatio Office Kosovo

Këshilli Rinor Kosovar

Kosovar Youth Council

KNK

Këshilli i Nxënësve të Kosovës
Student Council of Kosova

RAPORTI PËR **KËSHILLIN DREJTUES TË SHKOLLËS**

Mars, 2017

Monitorimi i Këshillit Drejtues të Shkollës

Këshilli Rinor Kosovar (KYC)
Këshilli i Nxënësve të Kosovës (KNK)

RAPORT PËR KËSHILLIN DREJTUES TË SHKOLLËS

Ky projekt është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)".

Mars, **2017**

1. Përmbajtja

1.	Përmbajtja	4
2.	Shkurtesat	5
3.	Të flasim për sukseset	6
4.	Hyrje	7
5.	Rëndësia e monitorimit të Këshillit Drejtues të Shkollës	8
6.	Metodologjia	9
7.	Të dhënat dhe statistikat e dala nga monitorimi	10
8.	Rekomandime	24
9.	Falënderime	25
10.	Ligji për Arsimin Parauniversitar - Përgjegjësitë e Institucioneve Arsimore	26
11.	Formulari	28

Ky raport është realizuar me përkrahjen nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO–K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e Këshillit Rinor Kosovar dhe Këshillit të Nxënësve të Kosovës dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO–K-së apo KCSF-së.

2. Shkurtesat

MAShT	Ministra e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
KNK	Këshilli i Nxënësve të Kosovës
KYC	Kosovar Youth Council (Këshilli Rinor Kosovar)
YMG	Youth Monitoring Group (Grupi i Monitoruesve të Rijnë)
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
KDSH	Këshilli Drejtues i Shkollës
KN	Këshilli i Nxënësve
SCO-K	Swiss Cooperation Office in Kosovo (Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë)
KSCF	Kosovar Civil Society Foundation (Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile)
DSP	Democratic Society Promotion (Promovimi i Shoqërisë Demokratike)
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
ISCED	International Standard Classification of Education (Standardi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit)

3. Të flasim për sukseset

Këshilli Rinor Kosovar ka filluar monitorimin e Këshillit Drejtues të Shkollës që nga viti 2012 me qëllim implementimin e legjislacionit, fuqizimin dhe strukturimin e këtij organi vendim-marrës që do të shërbente për përmirësimin e gjendjes së arsimit brenda shkollave.

Fillimisht, në vitet e para të monitorimit KYC e ka vërejtur që përkundër hyrjes në fuqi të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, rrjedhimisht neni 17 që e rregullon funksionimin e Këshillit Drejtues të Shkollës, ai nuk është implementuar me saktësi. Kështu që, pas angazhimit dhe rekomandimeve tona krahasuar monitorimin paraprak[1] ku Këshillat Drejtues së Shkollave nuk kanë qenë shumë funksional dhe shumë nga të intervistuarit as që kanë pasur njohuri për këtë strukturë, së fundmi është vërejtur përmirësim i kënaqshëm dhe si rezultat kemi Këshilla Drejtues të Shkollës shumë më funksional.

Gjithashtu, përmirësimi për të cilin ka lobuar KYC vazhdimisht, përgjatë monitorimit të këtij organi vendim-marrës ka qenë fakti që nxënësit dhe Këshilli i Nxënëseve në shkollë të konsiderohen si palë e rëndësishme sepse asnjëherë më parë nuk janë konsideruar dhe shumë rrallë janë dëgjuar interesat dhe nevojat e tyre brenda këtij institucioni. Zakonisht për nxënësin jemi mësuar të shohim se si vendosin hisedarët institucional, udhëheqësit e shkollave, mësimdhënësit e prindërit përderisa asnjëri nga ta nuk njeh më mire se vet nxënësi nevojat e tij.

Kësisoj, nëse kthehemi në monitorimin e Këshillit Drejtues të Shkollës të vitit 2012 e shohim që nxënësit nuk janë ftuar në mbledhjet e këtij organi dhe madje edhe në rastet kur ata janë ftuar nuk kanë pasur mundësi të diskutojnë dhe ngrisin tema relevante të rëndësishme për edukimin e tyre. Monitorimi i vazhdueshëm i KYC ka arritur të shënoj progres në këtë çështje me ç 'rast me aktin nën ligjor Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2016 Këshilli Drejtues i Shkollës, Neni 3, Paragrafi 1.4 tashmë nxënësit konsiderohen palë e qëndrueshme e Këshillit Drejtues të Shkollës që do të thotë pjesëmarrja e tyre në të gjitha zhvillimet e këtij organi është e obligueshme.

Vlen të theksohet, që tashmë dhe vet nxënësit janë bërë të vëmendshëm karshi kërkesave të tyre për të qenë pjesë e vendimmarrjes, ku në këtë rast do ti potenconim dhe fjalët e një nxënëseje përfaqësuese e shkollës së saj në Këshillin e Nxënësve të Kosovës e cila tha: "Më herët nuk jam ftuar në asnjë mbledhje të Këshillit Drejtues të Shkollës, as që e kam ditur që kam të drejtë. Mirëpo, pas informatës tuaj dhe monitorimit që e keni bërë, unë menjëherë kam kërkuar nga udhëheqësit e shkollës të më përfshijnë në këtë organ duke qenë se kam të drejtë të plotë. Ata kanë pranuar kërkesën time dhe sot vazhdojnë të më njoftojnë për të gjitha takimet dhe aktivitetet".

Përveç kësaj, ky monitorim ka ndihmuar në ngritjen e vetëdijes për secilin hisedarë brenda KDSH-së duke i bërë ata të kuptojnë për rëndësinë e këtij organi edhe pse përsëri ka shumë çështje që duhet vlerësuar dhe përmirësuar në vazhdimësi të cilat do ti hasni më poshtë në tekst dhe në rekomandime.

1 Raport "Vendim-marrja për nxënës pa nxënës"- Monitorimi i Këshillit Drejtues të Shkollës, 2012/13 http://kyc-ks.org/publications/vendim-marrja_per_nxenes-pa_nxenes_-_2012-13.pdf

4. Hyrje

KNK dhe KYC duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, neni 17, si dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2016 lidhur me Këshillin Drejtues të Shkollës i cili është i definuar si organ udhëheqës i shkollës, edhe këtë vit për të tretën herë me radhë bëri monitorimin e punës së këtij organi vendim-marrës.

Monitorimi si bazë hulumtuese kishte dhe çështjen e përfshirjes së nxënësve në vendim-marrje e cila cilësohet si një nga proceset më të rëndësishme për ngritjen e cilësisë në arsim, dhe ndër të tjera monitorimi ka pasur për qëllim përcjelljen e zbatimit të Udhëzimit të ri Administrativ Nr. 03/2016 që rregullon funksionin e Këshillit Drejtues të Shkollës. Ky monitorim ishte pjesë e programit vjetor të KNK-së i përpiluar dhe miratuar më 12 Dhjetor 2015 në takimin e Këshillit Drejtues të KNK-së.

Ky monitorim është vazhdimësi e dy monitorimeve paraprake rreth çështjes së ngjashme. Monitorimet paraprake janë realizuar në vitet 2011/12 dhe 2012/13 duke i prirë lansimeve të dy raporteve me të gjetura esenciale të përcjella me rekomandime drejtuar organeve kompetente dhe të gjithë hisedarëve të tjerë.

Realizimin e monitorimit të paraparë si iniciativë e nevojshme në arsim e kanë përkrahur dhe institucionet si Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Inspektorati për Arsim si dhe Komisioni Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport. Monitorimi nxjerri të dhëna të cilat do të jenë në shërbim të institucioneve të lartë cekura si burim i informacioneve rreth gjendjes së Këshillave Drejtues të Shkollave të mesme në Kosovë duke inkurajuar kështu ndikimin në implementimin e akteve legjislative në fuqi.

Në këtë raport janë ofruar rezultate që tregojnë funksionalitetin e KDSH-ve në shkolla të mesme të vendit. Saktësisht, përqindja e shkollave që në tërësi e kanë të formuar Këshillin Drejtues të Shkollës dhe në sa prej tyre ky Këshill luan rolin dhe përgjegjësinë funksionale ashtu siç parashihet me legjislacion. Ndër të tjera, duke qenë se KDSH është organi më i lartë vendim-marrës brenda shkollës, në këtë raport paraqitet dhe relacioni i përfshirjes së palëve siç janë mësimdhënësit, prindërit, nxënësit dhe palët e jashtme përgjatë marrjes së vendimeve në interes të shkollës.

Këshilli i Nxënësve të Kosovës e ka statutin e vet dhe strukturën e brendshme ekzekutive.

Ky projekt ka përkrahje financiare nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP)- i financuar nga Zyra Zvicerane për bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

5. Rëndësia e monitorimit të Këshillit Drejtues të Shkollës

Këshilli Drejtues i Shkollës është organi më i lartë vendim-marrës i shkollës themeluar në bazë të nenit 17 të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar[1] të Republikës së Kosovës , veprimtaria e të cilit rregullohet po ashtu edhe me akt nënligjor siç është Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2016 Këshilli Drejtues i Shkollës. Ky Këshill sipas udhëzimit duhet të ketë përbërje përfaqësimi nga të gjithë hisedarët brenda shkollës dhe strukturave të tjera përkatëse, duke nisur kësisoj nga përfaqësimi i drejtorit i cili në KDSH ka vetëm rolin e sekretarit, pastaj përfaqësimi i mësimdhënësve, prindërve, nxënësve, stafit teknik dhe palëve të jashtme siç mund të jenë përfaqësues nga shoqëria civile, si dhe palë me interes të emëruar nga komuna. Përfaqësimi i KDSH-së në përmbajtje me të drejtë vote ka tre (3) prind, tre (3) mësimdhënës, dy (2) përfaqësues të shoqërisë (palë me interes të emëruara nga komuna) dhe (1) një përfaqësues i nxënësve. Këta përfaqësues do të duhej të zgjidheshin nga strukturat që i përfaqësojnë vetë ata nëpërmjet zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Në shkollat që kanë më shumë se një mijë (1000) nxënës numri i anëtarëve duhet të ngritet në 4-4-3-2 në kategoritë përkatëse sipas paragrafit të lartpërmendur.

Kryetari i Këshillit Drejtues të Shkollës zgjidhet në mbledhjen e parë të KDSH-së dhe në bazë të ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës, neni 17 pika 7 kjo pozitë i takon njërit nga përfaqësuesit të prindërve pas votimit të pjesëtarëve të KDSH-së, ndërsa Drejtori i shkollës në bazë të të njëjtit ligj pika 8, ushtron funksionin e sekretarit të KDSH-së me të drejtë debati por jo të drejtë vote. Këshilli Drejtues i Shkollës ka mandat 3 vjeçar me kushtin që anëtarët/përfaqësuesit të vazhdojnë të jenë mësimdhënës, prind dhe nxënës të shkollës përkatëse. Kryetari i Këshillit Drejtues në bazë të ligjit mbi Arsimin Parauniversitar, neni 17 (Këshilli Drejtues), pika 1 është i obliguar që së paku çdo tre (3) muaj të mbledh Këshillin Drejtues. Në rast se KDSH nuk formohet ose mblidhet në periudhë prej tre (3) muajsh sipas legjislacionit në fuqi, të gjitha kompetencat i kalojnë Drejtorit të shkollës, mirëpo kjo nën kushtin që Komuna përkatësisht Drejtoria Komunale për Arsim në bashkëpunim me Drejtorin e shkollës përkatëse të përpiqen vazhdimisht për formimin dhe funksionalizimin e KDSH-së sipas indikacioneve ligjore.

Këshilli Drejtues i Shkollës si organi më i lartë vendim-marrës në shkollë ka kompetenca dhe detyra të shumta karshi çështjeve të shkollës. Sipas ligjit mbi Arsimin Parauniversitar detyrat e tij klasifikohen si: të hartojë rregullat e shkollës të specifikuara në nenin 22 të po këtij ligji; të zgjedhë një përfaqësues të prindërve dhe një të mësimdhënësve nga anëtarët e KDSH-së që të marrin pjesë në cilësinë e vëzhguesit në emërimin e drejtorit, zëvendësdrejtorit dhe mësimdhënësve të shkollës; të ushtrojë funksionet e ndërlidhura me shfrytëzimin e buxhetit të shkollës përfshirë edhe skemën e delegimit mes komunës, organit drejtues të shkollës dhe drejtorit të shkollës; të vendos për shfrytëzimin e fondeve që i janë dhënë shkollës si kontribut nga prindërit ose donatorët tjerë; të miratojë aktivitetet jashtë kurrikulës së shkollës sipas propozimit të drejtorit të shkollës; të vendosë për kodin e veshjes së punonjësve dhe nxënësve; të shpreh pikëpamjet e veta për çështje që kanë të bëjnë me shkollën apo çfarëdo aspekti të arsimit parauniversitar; të miratoj listën e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera shkollore për të i përdorë në shkollë në bazë të propozimeve të mësimdhënësve të shkollës varësisht plan programeve të hartuara, brenda kufizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi; të kontribuojë në hartimin e planit zhvillimor të arsimit nga komuna në raste kur ka të bëjë me shkollën përkatëse; të ushtrojë funksionet e tjera që i janë deleguar nga komuna në pajtim me ligjin. Të gjitha këto janë të bazuara në nenin 17 të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar pika 11 e cila flet për kompetencat dhe përgjegjësit e Këshillit Drejtues të Shkollës.

Qëllimi kryesor i monitorimit të KDSH-ve është analizimi i çështjes së përfaqësimit të duhur të nxënësve në këtë organ vendim-marrës si palë e rëndësishme. Duke u bazuar në statistika të cilat do t'i ofrojë ky raport, institucionet relevante mund të ndërmarrin hapa konkret drejtë zbatimit të plotë të ligjit dhe përmirësimit të gjendjes aktuale lidhur me funksionimin e këtij organi.

1 LIGJI Nr. 04/L-032 PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, Përgjegjësitë e institucioneve arsimore, neni 17 Këshilli Drejtues, fq.14 - http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/1-ligji-per-arsimin-parauniversitar.pdf

6. Metodologjia

Monitorimi i KDSH-së është realizuar përgjatë datës 10 shkurt 2016 deri më datën 30 mars 2016 në gjithsej 84 shkolla të mesme të 29 komunave të ndryshme të Kosovës. Realizimi i monitorimit nuk ka arritur ti përfshij vetëm komunat në të cilat ka pasur mungesë të shkollave të mesme si dhe komunat shkollat e mesme të cilave nuk mësojnë sipas sistemit arsimor të Republikës së Kosovës (komunat me shumicë serbe). Komunat në të cilat është realizuar monitorimi janë : Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Novobërdë, Klinë, Kamenicë, Vushtrri, Drenas, Lipjan, Shtime, Skenderaj, Suharekë, Obiliq, Fushë Kosovë, Podujevë, Viti, Dragash, Malishevë, Deçan, Hani i Elezit, Istog, Junik, Rahovec, Kaçanik dhe Shtërpcë. Monitorimi është realizuar me ndihmën e YMG-ve, KNK-së dhe KYC-it. Ndërkaq, para procesit të monitorimit të gjithë monitoruesit kanë kaluar nëpër trajnime me bazë etikën dhe mënyrën e realizimit të monitorimit në mënyrë që ky proces të jetë sa më efektiv.

Për këtë monitorim është përdorur metoda krahasuese, me ç 'rast krahasohen rezultatet e përgjigjeve të gjithë hisedarëve të KDSH-së. Do të thotë, përfshihen rezultatet e Nxënësve, Drejtorëve, Mësimdhënësve dhe Prindërve.

Monitorimi është bërë nëpërmjet plotësimit të formularëve të përgatitur me përpikëri me ndihmën e konsulentëve të jashtëm për arsim në mënyrë që pyetjet të jenë në përputhshmëri me nevojën për hulumtim. Këta formular janë plotësuar nga monitoruesit e angazhuar. Në çdo shkollë të monitoruar kryesisht janë plotësuar një (1) formë e formularit me tre deri në pesë (3 – 5) të intervistuar. Një formë është plotësuar gjatë intervistimit të Drejtorit të shkollës (në cilësinë e sekretarit të KDSH-së), një deri në tre (1 – 3) mësimdhënës pjesë përfaqësuese e KDSH-së të asaj shkolle dhe përfaqësuesi legjitim i nxënësve. Formularët janë plotësuar në prani të përfaqësuesve të YMG-së të komunës përkatëse dhe përfaqësuesit të KYC-it që ka pasur rolin e mbikëqyrësit. Gjatë plotësimit të formularit përfaqësuesit tanë në raste specifike kanë bërë dhe pyetje shtesë në mënyrë që të grumbullohen sa më shumë informata dhe të dhëna mbi punën e Këshillit Drejtues të Shkollës.

Në përgjithësi janë plotësuar 249 formular nga ana e të intervistuarve apo më saktë 74 nga drejtorët e shkollave, 105 nga ana e mësimdhënësve dhe 70 nga përfaqësuesit e nxënësve. Përveç formës së plotësimit të formularëve, ekipi monitorues nga shënimet e marra gjatë kohës së intervistës kanë analizuar të dhëna edhe për çështje tjera shqetësuese për nxënësit, e që nuk kanë qenë të parashikuara në formularë por që dosido kanë rëndësi të veçantë.



7. Të dhënat dhe statistikat e dala nga monitorimi

7.1. A është mbledhur Këshilli Drejtues i Shkollës gjatë periudhës Shtator 2015 – Janar 2016?

Këshilli Drejtues i Shkollës sipas legjislacionit në fuqi, UA 03/2016 Neni 7, Pika 1 pas themelimit të tij është e paraparë që të takohet çdo tre (3) muaj për të i diskutuar çështjet e ndryshme të shkollës. Rreth pyetjes që i është drejtuar të intervistuarve nëse ky organ udhëheqës është mbledhur brenda periudhës Shtator 2015 - Janar 2016, nga 74 drejtor të intervistuar 91.89% janë përgjigjur pozitivisht, po ashtu nga 105 mësimdhënës të intervistuar 92.38% kanë thënë që ky organ është mbledhur. Për dallim vetëm 67.14% nga 70 nxënës të intervistuar janë përgjigjur njëjtë.



7.1.1.Nëse po, sa herë është mbledhur dhe kur?

Meqenëse përgjigjes paraprake i janë përgjigjur pozitivisht gjithsej 66 drejtorë, 95 mësimdhënës dhe 45 nxënës, të njëjtit kanë mundur të vazhdojnë intervistën karshi pyetjeve që lidhen direkt me funksionalitetin e KDSH-së.

Nga 66 drejtorë të intervistuar, 75.76% kanë deklaruar që janë takuar 1 – 3 herë, 15.15% kanë deklaruar që janë takuar 4 – 6 herë, ndërsa pjesa e mbetur prej 9.09% e drejtorëve kanë deklaruar që Këshilli Drejtues i Shkollës ka mbajtur takim më shumë se 6 herë.

Sa i përket mësimdhënësve, nga 95 të intervistuar, 74.74% kanë deklaruar që janë takuar 1 – 3 herë, 18.95% kanë deklaruar që janë takuar 3 – 6 herë, ndërsa pjesa e mbetur prej 6.32% e mësimdhënësve kanë deklaruar që Këshilli Drejtues i Shkollës ka mbajtur takim më shumë se 6 herë.

Ndërsa, nga 45 nxënës të intervistuar, 77.78% kanë deklaruar që janë takuar 1 – 3 herë, 8.89% kanë deklaruar që janë takuar 3 – 6 herë, ndërsa pjesa e mbetur prej 13.33% e nxënësve kanë deklaruar që Këshilli Drejtues i Shkollës ka mbajtur takim më shumë se 6 herë.



7.1.2.Kush e thërret Këshillin Drejtues të Shkollës suaj dhe a janë të obliguara shkollat vetë ta thërrasin atë?

Statistikat sipas intervistimit tregojnë që nga 74 drejtorë të intervistuar 58.11% e tyre kanë theksuar që vet e thërrasin këtë organ, ndërsa 24.32% organin e thërret Kryetari i KDSH-së ndërkaq një drejtor nuk pa pasur informacion rreth këtij detaji.

Ndërkaq, sipas 105 mësimdhënësve të intervistuar 48.57% prej tyre kanë thënë që organi thirret nga Drejtori, ndërsa 27.62% organin e thërret Kryetari i KDSH-së, ndërsa 6 prej mësimdhënësve të intervistuar nuk kanë pasur përgjigje.

Sipas 52.38% të nxënësve organin e thërret Drejtori i shkollës përkatëse. 14.29% të tjerë kanë theksuar që ky organ thirret nga Kryetari i KDSH-së ndërkaq 16 nxënës nga 63 të intervistuar nuk e kanë këtë njohuri.

Pyetja 1.2



7.1.3.Kush e menaxhon shkollën në rast të mosfunksionimit të Këshillit Drejtues të Shkollës?

Sipas legjislacionit në fuqi UA Nr. 03/2016 Neni 7, Pika 1 nëse Këshilli Drejtues i Shkollës nuk zgjidhet brenda periudhës 3 mujore kompetencat i kalojnë Drejtorit të shkollës, me kusht që ky i fundit në bashkëpunim me DKA-në të bëj përpjekje të vazhdueshme për funksionalizimin e tij.

Nga 69 drejtorë të intervistuar, në këtë rast 84.06% prej tyre kanë potencuar që vet drejtori e menaxhon shkollën në rast të mos funksionimit të KDSH-së. 2.9% drejtorë kanë thënë që kompetencat i kalojnë stafit të shkollës. Ndërkaq 10.14% prej drejtorëve të intervistuar nuk kanë pasur fare informacion se kujt i takojnë kompetencat në rast se Këshilli Drejtues i Shkollës nuk është mbledhur sipas kohës së paraparë në ligj.

Pyetja 1.3



Mësimdhënësit, po ashtu sipas përgjigjeve të një mase të madhe prej 63.11% e tyre nga 103 të intervistuar kanë thënë që shkollën e menaxhon drejtori. Sipas 4.85% mësimdhënësve, ne rast të mos funksionimit të KDSH-së merret si opsion menaxhimi i shkollës nga stafi i shkollës. Ndërkaq, 20.39% e tyre nuk kanë informacion se kush e menaxhon shkollën në rast të mosfunksionimit të Këshillit Drejtues të Shkollës.

Ndërsa, në rastin e nxënësve nga 69 nxënës të intervistuar, 48.44% e tyre mendojnë që drejtori e menaxhon shkollën në rast të mosfunksionimit të KDSH-së, ndërsa 35.94% nuk kanë informacion se nga kush menaxhohet shkolla në rast të mosfunksionimit të KDSH-së.

7.2. A ka procesverbal të takimit të mbajtur?

Nga 68 drejtorë të intervistuar, 95.59% janë përgjigjur që kanë procesverbal të takimeve të mbajtura ndërsa vetëm 4.41% kanë deklaruar që nuk kanë procesverbale. Sa i përket mësimdhënësve të intervistuar, nga 97 mësimdhënës të intervistuar 96.91% kanë deklaruar që shkolla posedon procesverbal të takimeve të mbajtura dhe vetëm 3.09% e tyre kanë deklaruar që shkolla nuk posedon procesverbal.

Ndërsa, sa i përket nxënësve, nga gjithsej 47 nxënës të intervistuar, 87.23% deklarojnë që shkolla ka procesverbal. Ndërsa pjesa e mbetur prej 12.77% janë përgjigjur që shkolla nuk ka procesverbale të takimeve të mbajtura të Këshillit Drejtues të Shkollës.



Mirëpo, edhe pse pjesa më e madhe e të intervistuarve kanë deklaruar që kanë procesverbal të takimeve, monitoruesit kanë arritur t'i sigurojnë vetëm 29 kopje të procesverbaleve të mbajtura. Në shumicën e rasteve drejtorët dhe mësimdhënësit kanë hezituar të i lejojnë monitoruesit të kenë qasje në këtë lloj dokumenti.

7.3. A ka dokument tjetër që vërteton mbajtjen e takimit të Këshillit Drejtues të Shkollës?

Në pyetjen se "A ka dokument tjetër që vërteton mbajtjen e takimit të Këshillit Drejtues të Shkollës", nga 68 drejtorë të intervistuar, 41.18% kanë deklaruar që kanë edhe dokumente të tjera përpos procesverbalit. Ndërsa pjesa tjetër prej 58.82% treguan që shkolla nuk ka dokumente të tjera përpos procesverbalit.

41.24% nga 97 mësimdhënës të intervistuar në këtë pyetje kanë deklaruar që shkolla ka edhe dokumente të tjera që vërtetojnë takimet e mbajtura. Ndërsa, 58.76% kanë deklaruar që shkolla nuk ka dokumente të tjera që e vërtetojnë mbajtjen e këtyre takimeve.



Ndërsa, nga 47 nxënës të anketuar 34.04% kanë treguar që ka edhe dokumente të tjera që vërtetojnë takimet e KDSH-së dhe pjesa prej 65.96% janë përgjigjur që shkolla nuk posedon dokumente të tjera në përjashtim të procesverbaleve.

Ndërkaq, monitoruesit tonë për këtë fakt nuk kanë siguruar dhe as nuk e kanë parë asnjë dokument tjetër që dëshmon punën e Këshillit Drejtues të Shkollës përveç procesverbaleve në rastet e pakta kur zyrtarët kanë lejuar qasje në to.

7.4. A kanë marrë pjesë përfaqësuesit e nxënësve në takimet e deritanishme të Këshillit Drejtues të Shkollës?

Sipas legjislacionit në fuqi Ligji Nr. 04/L-032 mbi Arsimin Parauniversitar, Neni 17, Pika 2.4 nxënësit tashmë konsiderohen pjesë pjesëmarrëse si anëtar permanent në Këshillin Drejtues të Shkollës. Varësisht numrit të nxënësve që ka shkolla të paktën një nxënës përfaqësues duhet të jetë pjesë e KDSH-së. Nxënësit nuk mund të marrin pjesë në takime vetëm gjatë rasteve kur diskutohet për çështjet që kanë të bëjnë me kushtet e punësimit apo çështjet personale të drejtorit, zëvendës-drejtorit, mësimdhënësve, punëtorëve tjerë të shkollës apo me çështje personale që kanë të bëjnë me nxënësit e tjerë.

Ndërkaq, sa i përket pjesëmarrjes së nxënësve në takimet e Këshillit Drejtues të Shkollës, 79.41% nga 68 drejtorë të intervistuar kanë deklaruar që përfaqësuesi i nxënësve është pjesë e takimeve dhe 20.59% treguan që pjesë e takimeve të KDSH-së nuk janë nxënësit përfaqësues të Këshillit të Nxënësve të shkollës përkatëse.



Nga 97 mësimdhënës të intervistuar, 84.54% deklaruan që përfaqësuesi i nxënësve është pjesë e këtyre takimeve ndërsa një përqindje prej 15.46% deklaruan që përfaqësuesi i nxënësve nuk merr pjesë në takimet të KDSH-së.

Nxënësit në anën tjetër, 47 të intervistuar të tillë, 89.36% e tyre kanë deklaruar që janë pjesë e takimeve të KDSH-së, ndërsa pjesa e mbetur prej 10.64% deklaruan që nuk janë pjesë e takimeve të Këshillit Drejtues të Shkollës edhe pse ata janë përfaqësues të Këshillit të Nxënësve të Shkollës së tyre.
Në këtë rast varësisht përgjigjeve vërehet një ndryshim dhe organizim më i përshtatshëm rreth Këshillit Drejtues të Shkollës për dallim me vitet paraprake[1].

Duhet të theksohet në veçanti respektimi i barazisë gjinore në përzgjedhjen e përfaqësuesve të nxënësve në KN respektivisht përfaqësimi në KDSH tutje, përgjithësisht në shkollat e mesme në Kosovë.

Si tregim suksesi që meriton të përmendet për arsye të rritjes së vazhdueshme nga viti në vit është numri i përfaqësueseve vajza në strukturën e KDSH-së në kategorinë e pjesëmarrjës së nxënësve. Nëse bëjmë një krahasim me vitet e kaluara shohim që për dallim nga periudha 2011/12[1] kur përfaqësuesit e nxënësve në më shumë se 50% të rasteve ishin djem, në vitet tutje vërehet një ngritje e numrit të përfaqësuesve vajza.



1 Raport "Vendim-marrja për nxënës pa nxënës"- Monitorimi i Këshillit Drejtues të Shkollës, 2012/13 http://kyc-ks.org/publications/vendim-marrja_per_nxenes-pa_nxenes_-_2012-13.pdf

7.4.1.Nëse PO, cilat janë temat e ngritura nga përfaqësuesi i nxënësve në këto takime?

Sipas intervistimeve të bëra me tërë hisedarët si drejtorët e shkollave, mësimdhënësit përfaqësues të Këshillit Drejtues të Shkollës si dhe vetë nxënësit është kuptuar që kryesisht temat që i parashtrojnë nxënësit përfaqësues në takimet e KDSH-së ku ata marrin pjesë varijojnë më shumë në diskutime që përgjithësisht nuk prekin problemet ose sfidat e nxënësve me fokus më të madh në proces mësimor. Sipas përgjigjeve temat që nxënësit më shumë parapëlqejnë të i diskutojnë janë **ekskursionet, uniforma e nxënësve, si dhe disiplina në shkollë.** Vetëm nganjëherë diskutohen aktivitetet jashtë mësimore dhe atë zakonisht flitet për turnirët sportiv ose ngjarje të ndryshme festive kombëtare apo për të i shënuar ditët e shkollës. Ndërkaq temat të cilat më së paku parashtrohen për diskutim apo vendim nga nxënësit janë çështjet rreth **cilësisë së arsimit** brenda shkollës përkatëse. Me raste, varësisht nevojave nxënësit paraqesin për diskutim edhe **transportin** për nxënësit që jetojnë në distancë të konsiderueshme larg shkollës ku ndjekin mësimin. Sidomos kjo në rastet e caktuara kur udhëtimi i tyre në këmbë mund të sjell dhe fatkeqësi.

7.5. Si është zgjedhur Këshilli i Nxënësve në shkollën tuaj?

Themelimi i Këshillit të Nxënësve së Shkollës parashihet në nenin 18 të Ligjit Parauniversitar Nr. 04/L-032. Këshilli Drejtues i çdo shkolle të nivelit 2 dhe 3 të ISCED-it themelon një Këshill të Nxënësve, i cili duhet të ketë së paku një nxënës të zgjedhur nga secila klasë dhe që zgjidhet çdo vit përmes votës së fshehtë. KYC ndër të tjera, vazhdimisht përkujdeset të shpërndajë me kohë udhëzuesin për themelimin e KN-ve që është i përkrahur dhe nga MAShT. Me ç 'rast nëpërmjet tij inkurajohen zgjedhje demokratike të kësaj strukture duke i lënë nxënësit që vet të vendosin për përfaqësuesit e zërit të tyre në shkollë.

Në pyetjen se si është zgjedhur struktura e KN-ve në shkollë drejtorët na kanë treguar që: 55.22% të rasteve të themelimit të KN-ve realizohen nëpërmjet kryesisë së nxënësve të klasave do të thotë kryetarët e klasëve vendosin për strukturën e Këshillit të Nxënësve të shkollës përgjithësisht. 34.33% prej tyre kanë thënë që KN zgjedhet me vota të lira të nxënësve(zgjedhje demokratike) ndërsa 10.45% prej drejtorëve kanë deklaruar që KN zgjedhet përmes mësimdhënësve ose nga vet drejtorët.

Ndërsa, përgjigjet e mësimdhënësve janë si vijon: 40.21% prej tyre kanë thënë që janë zgjedhur përmes kryesisë së nxënësve të klasave, 45.36% kanë deklaruar që KN zgjedhet me vota të lira të gjithë nxënësve. Ndërkaq, në 6.19% të përgjigjeve të mësimdhënësve thuhet se ata nuk kanë informacion për një proces të tillë. Mirëpo, 8.25% kanë njoftuar që ky këshill zgjedhet nga drejtori i shkollës apo nga mësimdhënësit përgjegjës varësisht preferencave të tyre.

Sa i takon përgjigjeve të nxënësve: 37.78% prej tyre tregojnë që Këshillin e Nxënësve e kanë zgjedhur përmes Kryesive të Nxënësve të klasave. Ndërsa, 48.89% kanë deklaruar që këtë Këshill e kanë themeluar përmes zgjedhjeve demokratike dhe votës së tyre ashtu siç inkurajohet. Një përqindje prej 4.44% prej përgjigjeve të nxënësve korrespondon me faktin që nuk kanë informacion. Mirëpo, 8.89% e nxënësve deklarojnë që KN-në në shkollën e tyre e ka zgjedhur drejtori i shkollës apo mësimdhënësit.

Pyetja 5



7.6. Sa është numri i nxënësve në shkollën tuaj?

Hapësira për përgjigje në këtë parashtrim të pyetjes ka qenë opsionale. Të intervistuarit kanë pasur mundësi të zgjedhin në mes (më shumë se 1000 nxënës) dhe (më pak se 1000 nxënës). Ndërkaq arsyeja e parashtrimit të kësaj pyetje e faktorizon respektimin apo mos respektimin e legjislacionit në fuqi që e rregullon çështjen e përfaqësimit të nxënësve varësisht numrit të tyre, në KDSH.



Nga gjithsej 67 drejtorë të intervistuar, 56.72% kanë deklaruar që shkolla që ata udhëheqin ka më pak se 1000 nxënës. Ndërkaq, 43.28% të tjerë kanë deklaruar që shkolla posedon më shumë se 1000 nxënës.

Prej 82 mësimdhënësve të intervistuar në këtë rast, 58.54% e tyre treguan se numri i nxënësve në shkollë është nën 1000 nxënës. Mirëpo, 41.46% mësimdhënësve deklaruan që në shkollën ku ata japin mësim ka më shumë se 1000 nxënës.

Sa i takon nxënësve, nga 37 nxënës, një përqindje prej 54.05% kanë deklaruar që sipas njohurive të tyre janë më pak se 1000 nxënës në shkollë. Ndërkaq përqindja tjetër prej 45.95% deklaruan që janë më shumë se 1000 nxënës që ndjekin mësim në shkolla.

Bazuar në intervistat e bëra në teren dhe listave të personave të cilët janë pjesë e KDSH-së të cilat KYC ka arritur ti mbledhë gjatë monitorimit tregohet qartë që neni 4 i UA Nr. 03/2016 mbi numrin e pjesëmarrësve dhe shpërndarjes së tyre (flasim këtu në bazë të pozitës) del që nuk zbatohet në 63% të rasteve apo përkthyer në numra, 53 shkolla në Kosovë nuk e përmbushin kërkesën ligjore për pjesëmarrje të palëve në KDSH, ndërsa për 27% të rasteve tjera apo 31 shkolla ky nen ligjor plotësohet.

Ndërsa, nëse shikojmë zbatimin e ligjit për shkollat të cilat kanë më shumë se 1000 nxënës situata veçse përkeqësohet. Në këtë kategori të shkollave përfshihen në total 29 shkolla, ku 86% prej tyre apo përkthyer në numër 25 shkolla nuk e zbatojnë ligjin mbi numrin e anëtarëve të KDSH-së dhe shpërndarjes së tyre. Legjislacioni që rregullon pjesëmarrjen përfaqësuese të pjesëtareve ka mangësi të shumta në respektim duke nisur nga fakti që përveç se nuk respektohet pjesëmarrja mbi 1000 nxënës, ligji nuk gjen zbatim as në përfaqësim të gjithë hisedarëve të nevojshëm edhe në shkollat nën 1000 nxënës.

Në tërë territorin e Kosovës vetëm 4 shkolla të cilat kanë më tepër se 1000 nxënës e përfillin në përpikëri nenin mbi numrin e anëtarëve dhe shpërndarjes së tyre në formë korrekte.



7.7. A marrin pjesë përfaqësuesit e prindërve në takim?

Ligji Nr. 04/L-032 në Pikën 2.1 të Nenit 17 rregullon përfaqësimin e prindërve në KDSH. Pas zgjedhjes së Këshillit të Prindërve në shkolla kjo strukturë në një formë apo tjetër është e ngarkuar të përkujdesët për përfaqësimin e prindërve në KDSH. Madje, vet kryetari i Këshillit Drejtues të Shkollës zgjidhet nga ana e prindërve.



Në këtë rast, 98.53% e drejtorëve nga gjithsej 67 të intervistuar ku KDSH është funksional, kanë deklaruar që pjesë e takimeve të Këshillit Drejtues të Shkollës janë edhe prindërit, ndërkaq vetëm 1.47% e drejtorëve tregojnë që në takimet e Këshillit Drejtues të Shkollës nuk marrin pjesë prindërit përfaqësues.

Nga 97 mësimdhënës të intervistuar , 91.75% tregojnë që në takimet e KDSH-së marrin pjesë edhe prindërit përfaqësues ndërsa një pjesë prej 8.25% treguan që në këto takime mungon prezenca e prindërve të përzgjedhur si përfaqësues.

Nga 47 nxënës intervistuar 80.85% deklarojnë që në mbledhjet ku këta kanë qenë prezent, prindërit kanë qenë pjesë e takimit. Në anën tjetër 19.15% e këtyre nxënësve kanë thënë që prindërit e përzgjedhur si përfaqësues nuk i kanë parë të marrin pjesë në takimet e Këshillit Drejtues të Shkollës.

7.7.1.Nëse PO, si janë zgjedhur këta përfaqësues?

Neni 4 i Udhëzimit Administrativ për zgjedhjen e anëtarëve të KDSH thotë që përfaqësuesit e Këshillit të Prindërve në KDSH duhet të zgjedhen me vota të fshehta nga Këshilli i Prindërve të Shkollës.

Procedura që ndiqet sipas shumicës së përgjigjeve të palëve të intervistuara në shkollat ku është realizuar monitorimi, për përzgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit të Prindërve në KDSH është si vijon: Fillimisht përzgjidhen kryetarët e KP-ve të klasës, pastaj këta me votat e tyre zgjedhin Këshillin e Prindërve të Shkollës dhe në të njëjtën kohë dhe përfaqësuesit e prindërve në KDSH.

Vlen të theksohet që një pjesë e konsiderueshme e nxënësve të intervistuar nuk kanë pasur fare njohuri rreth procedurës së përzgjedhjes së Këshillit të Prindërve të Shkollës dhe përfaqësuesve të këtyre të fundit në KDSH.

7.7.2.Cilat janë temat e ngritura nga përfaqësuesit e prindërve në këto takime?

Prindërit përfaqësues në mbledhjet e KDSH-së sipas të intervistuarve kryesisht i parashtrojnë pothuajse të njëjtat çështje si hisedarët e tjerë. Sidomos këto ngjasojnë me çështjet që parashtrojnë nxënësit, në këto takime.

Prindërit zakonisht këto takime i shfrytëzojnë për të paraqitur çështje diskutimi të tilla si **disiplina në shkollë, ekskursionet** e nxënësve maturantë rrjedhimisht preferencat e tyre përgjatë aktiviteteve si ekskursioni. Ndërkaq, tema të tjera që siç duket sipas përgjigjeve marrin trajtim të paktë janë pikërisht çështjet e **sigurisë në shkollë, mjedisit mësimor** dhe **cilësisë së arsimit përgjithësisht** në shkollat përkatëse.

7.8. A ka marrë pjesë edhe dikush tjetër në takimet e deritanishme?

Në takimet e KDSH-së përveç pjesëmarrësve hisedarë të zakonshëm, kryetari mund të ftoj dhe palë të treta varësisht interesit apo fushës së diskutimit në takime. Në të njëjtën kohë kjo e ndihmon procedurën e marrjes së vendimeve të këtij Këshilli karshi proceseve të ndryshme.



41.18% prej 68 drejtorëve të intervistuar kanë deklaruar që në këto takime kanë marrë pjesë edhe palë e tretë varësisht nevojës, ndërsa 58.82% e drejtorëve tregojnë që në këto takime nuk ka pasur persona të tjerë të jashtëm.

Mësimdhënësit e intervistuar për këtë pyetje, prej 97 gjithsej 40.21% e tyre kanë treguar që në takime kanë takuar edhe palë të tretë në raste të veçanta, ndërsa 59.79% e të intervistuarve tregojnë që në takime e deritanishme nuk ka pasur persona të tjerë përveç strukturës tashmë të njohur të KDSH-së.

Pjesa prej 42.55% e nxënësve, nga 47 në total të intervistuar, deklaruan që në takimet e KDSH-së ka pasur edhe persona të tjerë si palë e jashtme, ndërsa 57.45% e nxënësve tregojnë që në këto takime nuk kanë qenë pjesë e takimit edhe personat e jashtëm.

7.8.1.Nëse PO, kush ka marrë pjesë?

Sipas përgjigjeve të intervistuarve nga ana e drejtorëve, mësimdhënësve dhe nxënësve duke e pasur parasysh që një masë e madhe e tyre kanë pranuar që në mbledhjet e KDSH-së marrin pjesë edhe pjesëtarë të jashtëm, ky hulumtim tutje e konfirmon që si palë e jashtme në mbledhjet e Këshillit Drejtues të Shkollës zakonisht ftohen pjesëmarrës nga kategoritë si: shoqëri civile, drejtoritë komunale të arsimit si dhe nga përfaqësuesit e bizneseve.

7.9. A ka nxënës të komuniteteve pakicë në shkollën tuaj?

Në shumë shkolla të mesme të Kosovës mësimin ndjekin dhe nxënës nga komunitetet të cilët shpesh ballafaqohen dhe me sfida të llojit ku i duhet të mësojnë në paralele të ndara, ndonjëherë dhe me program të ndryshëm. Mirëpo, në pjesëmarrjen e tyre aktive rol të madh luan përfshirja e tyre në struktura vendim-marrëse apo udhëheqëse.



Fillimisht nga 68 drejtorë të intervistuar, 60.29% e tyre kanë deklaruar që pjesë të nxënësve kanë edhe nxënës nga komunitetet pakicë në Kosovë, ndërsa, 39.71% prej tyre janë përgjigjur që nuk kanë nxënës të komuniteteve pakicë në shkollën e tyre.

Sa i përket mësimdhënësve, nga 97 mësimdhënës të intervistuar, 51.55% deklarojnë që kanë nxënës të komuniteteve pakicë të cilëve ata iu ligjërojnë. Ndërsa 48.45% e mësimdhënësve tregojnë që nuk kanë nxënës të komuniteteve të tjera në përjashtim të komunitetit shqiptarë në shkollat ku ata ligjërojnë.

Nga 47 nxënës të intervistuar në këtë rast, 40.43% e tyre tregojnë që në shkollën e tyre kanë bashkëmoshatarë edhe të komuniteteve të tjera, ndërsa 59.57% tregojnë që nuk kanë takuar bashkëmoshatarë të komuniteteve pakicë në shkollën apo klasën ku ata ndjekin mësimin.

7.10. A ka përfaqësues të komuniteteve pakicë në kuadër të prindërve në Këshillin Drejtues të Shkollës?

Legjislacioni në fuqi që rregullon punën dhe funksionimin e Këshillit Drejtues të Shkollës e rregullon edhe pjesëmarrjen e komuniteteve në KDSH ku në Nenin 17, Pika 1 thuhet se duhet të përfshihen tre (3) përfaqësues të prindërve, duke përfshirë së paku një përfaqësues të komuniteteve jo shumicë në komunë nëse ka ndonjë nxënës nga ato komunitete në atë institucion. Në këtë rast, ligji parasheh që nëse në shkollë ka pjesëmarrje të komuniteteve, brenda KDSH-së duhet të ketë një prind përfaqësues të komunitetit përkatës gjithsesi.



Respondentët të cilët në pyetjen 7.9 janë përgjigjur me "PO", i'u adresua pyetja nëse kanë prindër përfaqësues nga komunitetet pakicë në kuadër të Këshillit Drejtues të Shkollës, me ç'rast nga 41 drejtorë të intervistuar, 39.02% tregojnë që kanë prindër përfaqësues të komuniteteve pakicë në KDSH, ndërsa 60.98% e drejtorëve të intervistuar kanë thënë që nuk kanë prindër përfaqësues në Këshillin Drejtues të Shkollës.

Nga 50 mësimdhënës të intervistuar pjesa prej 22 % tregojnë që kanë prindër përfaqësues të komuniteteve pakicë në KDSH, ndërsa pjesa tjetër prej 78% deklarojnë që nuk kanë prindër përfaqësues të komuniteteve të tjera në Këshill Drejtues të Shkollës.

Sa i përket 19 nxënësve të intervistuar, 63.16% e tyre tregojnë që në KDSH ka prindër përfaqësues të këtyre komuniteteve, ndërsa 36.84% deklarojnë që nuk kanë prindër përfaqësues në Këshill Drejtues të Shkollës, gjithmonë duke e pasur parasysh numrin e nxënësve që veç marrin pjesë në mbledhjet e KDSH-së.

7.11. A është ftuar ndonjë përfaqësues i Drejtorisë Komunale të Arsimit në takime?

Zakonisht përfaqësuesit e Drejtorisë Komunale të Arsimit ftohen si palë e tretë në takime kur KDSH ka nevojë për diskutime dhe vendime që e prekin veprimtarinë e shkollës, qoftë kjo edhe për ndarje buxheti apo organizime të ndryshme.

Në këtë rast, 52.94% e drejtorëve, nga gjithsej 68 drejtorë të intervistuar deklarojnë që kanë ftuar përfaqësues të Drejtorisë Komunale të Arsimit në takimet e Këshillit Drejtues të Shkollës herë pas here sipas nevojës së paraqitur, ndërsa 47.06% e drejtorëve tregojnë që asnjëherë nuk kanë ftuar përfaqësues të DKA-së në këto takime.



Nga 97 mësimdhënës të intervistuar, 54.64% e tyre deklaruan që Këshilli Drejtues i Shkollës ka ftuar zyrtarë nga Drejtoria Komunale e Arsimit në komunën tyre, ndërsa 45.36% tregojnë që nuk ka marrë pjesë ndonjë zyrtarë nga DKA në takimet e KDSH-së.

Pyetja i është drejtuar dhe 47 nxënësve të intervistuar, ku 48.94% e tyre tregojnë që në takimet e KDSH-së në rastet ku edhe ata kanë qenë prezent ka pasur të ftuar si përfaqësues nga Drejtoria Komunale e Arsimit. Ndërsa, 51.06% e nxënësve tregojnë që në takimet e KDSH-së në shkollat e tyre nuk janë ftuar zyrtarë të Drejtorisë Komunale të Arsimit.

7.12. A e ka vizituar ndonjëherë shkollën tuaj ndonjë zyrtar i Inspektoratit të Arsimit të Kosovës?

Në mënyrë që një shkollë të funksionoj sipas standardeve të parapara në legjislacionet që rregullojnë fushën e arsimit, këto shkolla do të duhej të vizitohesh-in nga inspektorati për arsim, për të shqyrtuar ose inspektuar me detaje angazhimin dhe funksionalitetin e shkollës si dhe udhëheqësisë së saj. Kjo dhe për të kërkuar përmirësimin e problematikave dhe çështjeve të tjera relevante në shkollat përkatëse.



Shkollat janë vizituar nga zyrtarë të Inspektoratit për Arsim sipas 91.18% e 68 drejtorëve të intervistuar, ndërsa vetëm 8.82% e drejtorëve tregojnë që shkollën e tyre nuk e kanë vizituar asnjëherë Inspektorati për Arsim.

88.66% e mësimdhënësve të intervistuar nga gjithsej 97, tregojnë që shkolla ku ata mbajnë mësim është vizituar nga Inspektorati për Arsim, ndërsa 11.34% tregojnë që nuk kanë parë ndonjëherë zyrtar nga Inspektorati për Arsim në shkollën tyre.

Pjesa më e madhe e nxënësve 76.60%, nga gjithsej 47, kanë deklaruar që shkolla ku ata vijojnë mësimin është vizituar nga zyrtar të inspektoratit për arsim, ndërsa pjesa e mbetur 23.40% deklarojnë që shkolla e tyre nuk është vizituar ndonjë herë nga ndonjë zyrtar i Inspektoratit për Arsim.

7.13. A është marrë ndonjë vendim nga Këshilli Drejtues i Shkollës deri tani?

Meqë Këshilli Drejtues i Shkollës konsiderohet organ vendim-marrës, në këtë rast ka fuqinë madhore për marrjen e vendimeve në raport me çështjet e shkollës. Zakonisht vendimet merren me pajtimin e të gjithë anëtarëve në Këshill, dhe kryesisht me votim. Në këto raste nëse Këshilli funksionon siç parashihet në Nenin 17, Pika 8 e Ligjit Nr. 04/L-032 mbi Arsimin Parauniversitar, të gjithë përveç drejtorit të shkollës që ka rolin e sekretarit kanë të drejtë vote në marrjen e vendimeve.



Kur janë pyetur nëse në Këshillin Drejtues të Shkollës është marrë ndonjë vendim për çështjet e ndryshme të shkollës, 92.65% e drejtorëve nga 68 të intervistuar kanë deklaruar që në këto takime janë marrë shumë vendime, ndërsa 7.35% e tyre tregojnë që në këto takime nuk kanë marrë ndonjë vendim.

Mësimdhënësit e intervistuar nga 97 në total, 90.72% e tyre kanë thënë që në takimet të KDSH-së janë marrë vendime të ndryshme, ndërsa 9.28% e të intervistuarve tregojnë që në takime të KDSH-së nuk është marrë ndonjë vendim deri më tani.

Ndërsa, nga 47 nxënës të intervistuar, pjesa më e madhe e tyre prej 76.60% e nxënësve deklaruan që në takimet ku ata kanë qenë pjesë e tyre, janë marrë disa vendime nga ky Këshill, ndërsa 24.44% e nxënësve tregojnë që në këto takime nuk është marrë ndonjë vendim që do të mund të përmendet.

7.13.1.Nëse PO, cili ka qenë vendimi i fundit që ka marrë ky organ udhëheqës?

Nga pyetja paraprake, përgjigjet karshi marrjes së vendimeve nga Këshilli Drejtues i Shkollës nga të gjitha palët e intervistuara, kryesisht japin një përqindje pozitive që konfirmon se ky organ ka marrë vendime të ndryshme në lidhje me çështjet e shkollës.

Disa nga vendimet që këta hisedarë i kanë theksuar janë dhe **anulimi i çdo ekskursioni** tjetër përpos atij të fundit që realizohet si ekskursion kulturor për maturantët, **pajisja e nxënësve me uniforma**, në disa raste ky Këshill ka vendosur të funksionalizoj **bufetë** në shkollë, pastaj **funksionalizimi i kabineteve të ndryshme në shkollë, mbajtja e orëve shtesë** si dhe **mungesat e nxënësve** dhe **sanksionimet karshi numrit të madh të mungesave** janë disa nga vendimet që ky organ ka marrë.

Vërehet përgjithësisht se përkundër fuqisë çështjet e diskutimit dhe marrja e vendimeve në këtë Këshill kryesisht kanë përmasa logjistike dhe teknike ndërkaq janë të pakta vendimet që merren me qëllim të ngritjes së cilësisë së arsimit brenda shkollës.

7.14. Në takimet e deritanishme, a është marrë ndonjë vendim për nxënësit?

Takimet e Këshillit Drejtues të Shkollës në shumë raste mund të kenë si rezultat edhe marrjen e vendimeve për çështjet që i përkasin nivelit të nxënësve veçanërisht. Gjithsesi çështjet që kërkojnë vendim për nxënësit përveç që mund të parashtrohen nga zyrtarët e shkollës dhe prindërit që janë anëtar të këshillit, mund të iniciohen edhe nga vet nxënësit.



Pyetur se nga vendimet e marra deri më tani, a është marrë ndonjë vendim për çështjet e nxënësve, nga 63 drejtorë të intervistuar, 77.78% tregojnë që në mesin e shumë vendimeve të marra në KDSH, ka shumë prej tyre që janë marrë dhe ju takojnë çështjeve të nxënësve. Ndërsa 22.22% e drejtorëve të intervistuar tregojnë që nuk kanë marrë ndonjë vendim që ka të bëjë me nxënësit.

Ndërkaq, nga 88 mësimdhënës të intervistuar pjesa prej 87.50% tregojnë që në takimet e KDSH-së janë marrë vendime që kanë të bëjnë më nxënësit, ndërsa pjesa e mbetur prej 12.50% deklarojnë që në KDSH nuk është marrë ndonjë vendim që ka të bëjë direkt me nxënësit.

Sa i përket 36 nxënësve që janë përgjigjur në këtë pyetje, 77.78% e tyre tregojnë që Këshilli Drejtues i Shkollës ka marrë vendime që kanë të bëjnë me çështjet e nxënësit, ndërsa 22.22% deklarojnë që deri më tani Këshilli Drejtues i Shkollës nuk ka marrë ndonjë vendim për nxënësit.

7.14.1.Nëse PO, cilat janë vendimet e marra për nxënësit dhe si ka qenë procedura?

Kryesisht vendimet që merren në shkollë rreth nxënësve dhe çështjet që ju takojnë nxënësve, sipas një mase të madhe të intervistuarve që i janë përgjigjur këtij monitorimi konsiston që vendimet që merren për nxënësit kryesisht kanë të bëjnë me obligimin e mbajtjes së uniformës si rregull e dal nga ky Këshill, pastaj mungesat e tepërta të nxënësve në klasa dhe masat e suspendimit që merren për këtë kategori të nxënësve, tutje vijnë vendimet si ekskursioni për maturantë dhe rregullorja e sjelljeve për nxënësit në klasa dhe në objektin shkollor. Kjo na lë të nënkuptojmë që kryesisht, të gjitha vendimet më shumë paraqesin një formë logjistike me raste duke e anashkaluar kësisoj faktin që duhet trajtuar gjëra të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me cilësinë në arsim.

7.15. A është diskutuar për fondet e shkollës?

Kompetencë e Këshillit Drejtues të Shkollës si organi më i lart brenda shkollës është dhe ndarja dhe menaxhimi i fondeve që shkolla posedon. Në shumë raste ky organ vendos se ku do të i shfrytëzoj fondet e poseduara, cilat janë çështjet që kërkojnë intervenim dhe duhet investim, si dhe për vet rritjen e fondeve të rregulluara me UA 03/2016 neni 11 dhe 12.



Nga 68 drejtorë të intervistuar në këtë pyetje, 79.41% janë përgjigjur që gjatë takimeve të mbajtura është diskutuar edhe në lidhje me fondet e shkollës ndërsa 20.59% e drejtorëve kanë deklaruar që nuk është diskutuar fare mbi fondet e shkollës.

Sa i përket mësimdhënësve të intervistuar, nga 97 mësimdhënës të intervistuar 76.29% kanë deklaruar që në takime të Këshillit Drejtues të Shkollës është diskutuar për fonde të shkollës dhe pjesa prej 23.71% e tyre kanë deklaruar që në këto takime nuk është diskutuar për diçka të tillë.

Nxënësit, nga gjithsej 47 të intervistuar, 59.57% deklarojnë që në takimet ku nxënësit kanë qenë prezent është diskutuar për fonde ndërsa pjesa prej 40.43% janë përgjigjur që në KDSH nuk është diskutuar në lidhje me fondet e shkollës.

Përveç kësaj, dukuria që duhet të veçohet është që disa prej këtyre nxënësve të intervistuar kanë deklaruar që kur është diskutuar për fondet e shkollës nxënësit nuk janë lejuar të marrin pjesë në takim me arsyetim që është çështje delikate dhe ju takon vetëm zyrtarëve ta diskutojnë. Kjo në anën tjetër paraqet shkelje legjislacioni.

Tutje pyetjet 16-19 adresojnë statistikat rreth disa temave më të shpeshta që diskutohen në takimet e Këshillit Drejtues të Shkollës:

7.16. A është diskutuar për aktivitetet shtesë jashtë plan programit shkollor?

Statistikat tregojnë që nga 68 drejtorë të intervistuar 95.59% e tyre kanë theksuar që përveç aktiviteteve realizuar sipas plan programit shkollor, janë marrë edhe shumë vendime për aktivitete jashtë plan programit shkollor, sipas pjesës së mbetur 4.41% e drejtorëve tregojnë që nuk është diskutuar për ndonjë aktivitet shtesë.



Ndërkaq, sipas 97 mësimdhënësve të intervistuar, 88.66% prej tyre kanë thënë që në takimet e KDSH-së është diskutuar për aktivitete shtesë, sipas 11.34 % e mësimdhënësve deklarojnë që Këshilli Drejtues i Shkollës nuk ka diskutuar ndonjë herë për aktivitet jashtë plan programit.

Sipas 74.47% të nxënësve nga 47 të intervistuar tregojnë që në këto takime është diskutuar për aktivitete shtesë jashtë plan programit, ndërsa 25.53% të tjerë kanë theksuar që ky organ nuk ka diskutuar në lidhje me aktivitetet shtesë jashtë plan programit shkollor.

7.17. A është diskutuar veshmbathja/uniformat në shkollë?

Rreth kësaj pyetje nga 68 drejtorë të intervistuar, 89.71% e tyre kanë deklaruar që nxënësit janë të pajisur me uniformë prandaj dhe diskutohet çështja e tyre në KDSH, ndërsa, 10.29% janë përgjigjur që nuk është diskutuar për uniforma në mbledhjet e Këshillit Drejtues të Shkollës dhe që nxënësit e këtyre shkollave nuk janë të pajisur me uniforma.

Sa i përket mësimdhënësve, nga 97 të intervistuar, 95.88% deklarojnë që është diskutuar për uniformën në mbledhjet e KDSH-së ndërkaq vetëm një përqindje prej 4.12 % dëshmon që nuk është diskutuar për uniforma dhe nxënësit e asaj shkolle nuk janë të pajisur me to.



Ndërsa, nga 47 nxënës të intervistuar, 78.72% e tyre tregojnë që në mbledhje të KDSH-së ku ata kanë marrë pjesë është hapur diskutimi për mbajtjen e uniformës me ç'rast kjo përqindje veçse janë të pajisur me uniforma, ndërkaq 21.28% tregojnë që nuk kanë uniforma dhe nuk është diskutuar për to në mbledhje të KDSH-së.

7.18. A është diskutuar për tekstet mësimore?

Se a është diskutuar për tekstet mësimore në mbledhjet e Këshillit Drejtues të Shkollës drejtorët e intervistuar gjithsej 68, pjesa më e madhe e tyre 75% kanë deklaruar që në këto takime është diskutuar rreth teksteve mësimore, ndërsa pjesa prej 25% kanë deklaruar që në takime nuk është diskutuar ndonjë herë për tekstet mësimore karshi plan programeve dhe kurrikulës që zhvillohet.

Nga të gjithë mësimdhënësit e intervistuar 97, 90.72% deklarojnë që gjatë këtyre takimeve është ngritur për diskutim çështja e teksteve mësimore, ndërsa pjesa tjetër e intervistuar 9.28% tregojnë që nuk është diskutuar për tekstet mësimore në takimet e KD-së.



Në këtë rast nxënësit mendojnë pak më ndryshe. Nga 47 të intervistuar si përfaqësues të nxënësve në KDSH, 57.45% tregojnë që kanë rastisur të jenë prezent në takimet kur është diskutuar për tekstet mësimore, ndërsa 42.55% deklarojnë që asnjëherë nuk është diskutuar për tekstet mësimore në këto takime të KDSH-së.

Krahasuar këtë përgjigje me pyetjen paraprake 6.4.1 dhe 6.7.2 drejtuar hisedarëve rreth temave që më së shumti diskutohen në KDSH, kjo temë ka rezultuar si e pa përmendur. Ndërkaq, kur janë pyetur specifikisht rezultati dallon dukshëm.

7.19. A është diskutuar për Këshillin e Nxënësve të Shkollës?

Një ndër çështjet tjera relevante në të cilat është fokusuar ky monitorim ishte dhe rëndësia që i jepet Këshillit të Nxënësve të Shkollës dhe përfaqësimit të tyre në shkolla. Në këtë rast të intervistuarit janë

pyetur nëse diskutohet në mbledhjet e organit më të lartë të shkollës, për vet Këshillin e Nxënësve të Shkollës si strukturë përfaqësuese.

Nga 68 drejtorë të intervistuar, pjesa më e madhe e tyre 77.94% tregojnë që diskutohet edhe për KN-ën ndërsa pjesa e mbetur 22.06% tregojnë që në takime të Këshillit Drejtues të Shkollës, nuk diskutohet mbi temën e Këshillit të Nxënësve dhe çështjeve rreth tyre.

Nga 97 mësimdhënës të intervistuar, 80.41% tregojnë që pjesë e temave të diskutuara është edhe Këshilli i Nxënësve i Shkollës, ndërsa 19.59% deklarojnë që nuk diskutojnë asnjëherë për Këshillin e Nxënësve në takimet KDSH-së.



Nga 47 nxënës të intervistuar të cilët marrin pjesë në takimet e KDSH-së, 80.85% tregojnë që është diskutuar për Këshillin e Nxënësve në KDSH. Ndërsa 19.15% e nxënësve deklarojnë që nuk është diskutuar dhe nuk diskutohet për Këshillin e Nxënësve në këto takime.

Vlen të theksohet lidhja në mes të kësaj pyetje me pyetjet paraprake 6.4.1 dhe 6.7.2 ku nga temat e listuara për nxënësit, paraprakisht asnjëherë nuk është përmendur struktura e Këshillit të Nxënësve të shkollës si temë diskutimi.

7.20. A ka shkolla juaj regjistër të interesave personale dhe financiare të anëtarëve të tij dhe stafit drejtues të shkollës suaj?

Regjistrat e interesave personale dhe financiare të anëtarëve dhe stafit drejtues të shkollës janë dokumente të cilat parashihen të posedohen nga secila shkollë sipas legjislacionit në fuqi Ligji Nr. 04/L-032 Neni 17, Pika 16 që rregullon punën dhe angazhimin e Këshillit Drejtues të Shkollës. Mirëpo monitoruesit e angazhuar në këtë proces kanë vërejtur që në masë të madhe të intervistuarit nuk kanë pasur njohuri se çfarë janë dokumentet e tilla.



Në këtë rast, nga 68 drejtorë të intervistuar, 11.76% kanë deklaruar që shkolla ka regjistër të interesave personale dhe financiare të anëtarëve të tij dhe stafit drejtues të shkollës, ndërkaq pjesa prej 88.24% kanë deklaruar që nuk kanë ndonjë regjistër të interesave të tilla brenda shkollës ku ata udhëheqin.
Tek mësimdhënësit, nga 97 mësimdhënës të intervistuar, 23.71% kanë deklaruar që shkolla posedon një regjistër që i përket interesave personale dhe financiare të anëtarëve të tij. Ndërkaq pjesa tjetër e të intervistuarve 76.29% tregojnë që nuk kanë një regjistër të tillë.

Sa i përket nxënësve, nga gjithsej 47 nxënës të intervistuar, 17.02% deklarojnë që shkolla posedon një regjistër të interesave të ndryshme ndërsa pjesa më e madhe prej 82.98% janë përgjigjur që shkolla nuk posedon ndonjë regjistër të interesave personale dhe financiare të anëtarëve të tij dhe stafit drejtues të shkollës.

8. Rekomandime

Duke analizuar rezultatet e dala nga monitorimi dhe të gjeturave në teren, KYC dhe KNK rekomandojnë:

1. **H**artim/plotësim i Ligjit për Arsimin Parauniversitar neni 17, pika 1 . Kompetencat nuk duhet ti kalojnë drejtorit në asnjë rast nëse nuk themelohet Këshilli Drejtues i Shkollës sipas kohës së paraparë. Përkundrazi, në rast të mos themelimit duhet të parashihen në legjislacion masat e ndëshkimit.
2. Të ftohen përfaqësuesit e nxënësve në mbledhjet e KDSH-së ashtu siç e parasheh Ligji me theks të veçantë në rastet kur shkolla kalon numrin e nxënësve mbi 1000 dhe përfaqësimi bëhet me dy nxënës.
3. Takimet e Këshillit Drejtues së Shkollës duhet të evidentohen dhe dokumentohen me procesverbal apo formë tjetër dokumentacioni fizik që dëshmon mbajtjen dhe ecurinë e takimeve;
4. Nxënësit duhet të jenë prezent në çdo mbledhje si palë e përbërëse e KDSH-së ashtu siç parashihet me legjislacion përveç kur diskutohet për kushtet e punësimit apo çështje personale të drejtorit, zëvendësdrejtorit, mësimdhënësve, punëtorëve tjerë të shkollës apo edhe çështje personale të nxënësve tjerë.
5. Në rastet kur shkollat kanë më shumë se 1000 nxënës, duhet të përfillet dhe respektohet rregulla e ngritjes së numrit të anëtarëve në 4-4-3-2 në kategoritë përkatëse të përfaqësimit të palëve përbërëse të KDSH-së ashtu siç parashihet me legjislacion.
6. Nxënësit duhet të trajtohen si palë e barabartë, të respektohet e drejta e tyre në votim dhe të krijohet hapësirë për diskutim të temave relevante për ta.
7. Strukturat përfaqësuese të hisedarëve brenda shkollës si Këshilli i Prindërve dhe Këshilli i Nxënësve duhet të zgjedhen në formë demokratike. Po ashtu, inkurajohet pjesëmarrja aktive e prindërve në proceset shkollore.
8. Të rritet përgjegjshmëria e DKA-ve dhe përfaqësuesve delegues të tyre si palë e interesit brenda takimeve të KDSH-së.
9. Inspektorati i Arsimit të monitoroj punën dhe funksionimin e Këshillit Drejtues të Shkollave. Në rast të shkeljeve, pa rregullsive dhe mos respektimit të legjislacionit në fuqi ky institucion duhet të ndërmerr masa ndëshkuese. Monitorimi/Inspektimi i funksionalitetit të këtij organi do të duhej të bëhej më shumë se 1 herë në vit dhe atë pa paralajmërim.
10. Shkollat me prezencë të komuniteteve duhet të kenë përfaqësues prindër të komuniteteve në strukturën e KDSH-së ashtu siç parashihet në legjislacion. Në rast të mos respektimit, duhet të merren masa ndëshkuese.
11. Inkurajohet Këshilli Drejtues i Shkollave që në takimet e tyre të diskutojnë dhe tema me përbërje më të rëndësishme me qëllim ngritjen e cilësisë së arsimit brenda shkollave. Njëkohësisht, vendimet e marra duhet të trajtojnë dhe çështje të kësaj rëndësie sidomos vendimet që merren për nxënësit si pjesëtari kryesor i një shkolle;
12. Udhëheqësit e shkollave dhe KDSH duhet të informohen në lidhje me atë se çka nënkuptohet me regjistër të interesave personale dhe financiare të anëtarëve të KDSH-së dhe stafit drejtues të shkollës. Pas informimit, secila shkollë duhet të respektoj legjislacionin dhe domosdoshmërisht të i posedoj këto regjistra.

9. Falënderime

Në procesin e monitorimi të Këshillit Drejtues të Shkollës morën pjesë:

1. Agnesa Sylejmani
2. Agon Avdijaj
3. Agon Veselaj
4. Albina Raka
5. Albion Mustafa
6. Alma Gashi
7. Altin Gashi
8. Ardit Hoti
9. Arianit Halimi
10. Arjona Morina
11. Arta Ibrahimi
12. Arta Pllana
13. Bajrush Rrahmani
14. Bledion Ukimeri
15. Blendion Ukimeri
16. Blerina Pireva
17. Brahim Rexhaj
18. Bujar Kryeziu
19. Dardana Fetahu
20. Dhurata Hajdini
21. Diellza Krasniqi
22. Doruntina Aliu
23. Drenusha Jakupi
24. Drilon Balaj
25. Drin Syla
26. Driton Rexhepi
27. Edison Rrustemi
28. Edona Bllaca
29. Elind Ademaj
30. Elira Musa
31. Elsa Jaka
32. Elvira Dullovi
33. Elvis Derguti
34. Erblina Gerqari
35. Eronita Amerllahu
36. Eronita Podvorica
37. Erson Jonuzi
38. Etnik Berisha
39. Etnik Maloku
40. Ferik Sahiti
41. Fisnik Zhuriqi
42. Flaka Zymberaj
43. Flakrim Rrahimi
44. Fluska Aliu
45. Genc Bajgora
46. Gerta Sahiri
47. Granit Osa
48. Gresa Avdullahi
49. Jehona Kastrati
50. Jetlira Krasniqi
51. Kosovare Sertolli
52. Krenare Bërbadovci
53. Kujtim Jashari
54. Leonid Sylka
55. Leotrim Kokollari
56. Leotrim Pajaziti
57. Lirie Berisha
58. Lorina Idrizi
59. Malsore Gashi
60. Margarita Smakiqi
61. Marigona Gashi
62. Marigona Smakiqi
63. Mihrije Kadriu
64. Milot Mehmeti
65. Qëndresa Selimi
66. Qëndresë Morina
67. Ramadan Rexha
68. Rina Podvorica
69. Rizah Koraqi
70. Sadri Shehu
71. Shpend Mustafa
72. Uran Kastrati
73. Valdrin Smakiqi
74. Valeza Tahiri
75. Zanfina Xhemajli

Falënderojmë gjithë drejtorët dhe profesorët që ishin pjesëmarrës në procesin e monitorimit të funksionimit të këshillit drejtues të shkollës.

10. Ligji për Arsimin Parauniversitar - Përgjegjësitë e Institucioneve Arsimore

Neni 17

Këshilli drejtues

1. Çdo institucion publik arsimor dhe aftësues duhet të ketë këshillin drejtues. Në rast se këshilli drejtues nuk mund të formohet ose nuk mund të mblidhet në periudhën prej tre (3) muajsh, funksionet e tij merren nga drejtori i institucionit, me kusht që komuna (Ministria në rastet e institucioneve të nivelit 4 të ISCED-it) vazhdon me përpjekjet e mëtutjeshme për ta themeluar këtë këshill dhe për të mbajtur takimet e tij çdo tre (3) muaj.

2. Këshilli drejtues përbëhet nga:
   2.1. tre (3) përfaqësues të prindërve, duke përfshirë së paku një përfaqësues të komuniteteve jo shumicë në komunë nëse ka ndonjë nxënës nga ato komunitete në atë institucion;
   2.2. dy (2) përfaqësues nga shoqëria (palë me interes të emëruara nga komuna);
   2.3. tre (3) përfaqësues të mësimdhënësve
   2.4. për shkollat e nivelit 2 dhe 3 të ISCED-it, një përfaqësues të nxënësve, i zgjedhur nga nxënësit që vijojnë shkollimin.

3. Në rastet kur shkollat e nivelit 1-2 të I ISCED-it ose institucionet arsimore të nivelit 3 të ISCED-it kanë më shumë se 1000 nxënës, numri i anëtarëve duhet të ngritët në katër, në tre, në katër dhe në dy në kategoritë përkatëse sipas paragrafit 2. të këtij neni. Nëse numri i nxënësve bie nën 1000, numri i anëtarëve duhet të reduktohet në nivelin minimal, ashtu që anëtari që është zgjedhur i fundit në secilin grup të kryej mandatin e tij në fund të vitit shkollor.

4. Përfaqësuesit e prindërve në këshillin drejtues zgjidhen me votim të fshehtë nga anëtarët e Këshillit të Prindërve të Shkollës.

5. Këshilli drejtues ka të drejtë të caktojë përfaqësues shtesë pa të drejtë vote, për të siguruar përfaqësim të gjerë të punëdhënësve dhe shoqërisë në përgjithësi.

6. Mandati i anëtarëve të Këshillit drejtues zgjat tri (3) vite, me kusht që ata të vazhdojnë të jenë mësimdhënës, nxënës, prindër të nxënësve në shkollën përkatëse. Përfaqësuesit e prindërve dhe mësimdhënësve mund të zgjidhen në mandatin e dytë.

7. Kryetari i këshillit drejtues zgjidhet çdo vit nga këshilli drejtues nga radhët e përfaqësuesve të prindërve. Kryetari mund të rizgjidhet.

8. Drejtori i institucionit arsimor ushtron funksionin e Sekretarit të Këshillit drejtues. Drejtori i raporton Këshillit drejtues për çdo vit lidhur me aktivitetet dhe financat e institucionit, dhe ka të drejtën që të sugjerojë zgjidhje dhe të marrë pjesë në debate, por jo edhe të drejtën e votës. Drejtori i shkollës është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së Këshillit.

9. Këshilli drejtues i shkollës mund të ftojë Drejtorin komunal të arsimit dhe/ose zëvendësin e tij që të marrë pjesë në takimet e Këshillit, në mënyrë që të ofrojë informata ose sqarime apo të dëgjojë pikëpamjet e Këshillit drejtues, por pa të drejtë vote.

10. Këshilli drejtues gjatë zbatimit të kompetencave dhe detyrave të tij, i respekton parimet e arsimit parauniversitar të parapara në këtë ligj, duke përfshirë edhe respektimin e të drejtave të komuniteteve.

11. Këshilli drejtues i shkollës në nivelet 1,2 dhe 3 të ISCED-së, ka detyrat dhe kompetencat si vijon:

11.1. të hartojë rregullat e shkollës të specifikuara në nenin 22 të këtij ligji, për t'u miratuar nga komuna;

11.2. të zgjedhë një përfaqësues të prindërve dhe një të mësimdhënësve nga anëtarët e Këshillit Drejtues, që të marrin pjesë në cilësinë e vëzhguesve në emërimin e drejtorit, zëvendësdrejtorit dhe mësimdhënësve të shkollës;

11.3. të ushtrojë funksionet e ndërlidhura me shfrytëzimin e buxhetit të shkollës, përfshirë edhe skemën e delegimit mes komunës, organit drejtues të shkollës dhe drejtorit të shkollës, siç është përcaktuar në këtë ligj.

11.4. të vendosë për shfrytëzimin e fondeve që i janë dhënë shkollës si kontribut nga prindërit ose donatorët e tjerë;

11.5. të miratojë aktivitetet jashtë kurrikulare të shkollës, sipas propozimit të drejtorit të shkollës;

11.6. të vendosë për kodin e veshjes së punonjësve dhe nxënësve;

11.7. të shpreh pikëpamjet e veta për çështjet që kanë të bëjnë me shkollën apo çfarë-do aspekti të arsimit parauniversitar;

11.8. të miratojë listën e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera shkollore për t'u përdorë në shkollë në bazë të propozimeve të mësimdhënësve të shkollës, brenda ku-fizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;

11.9. të kontribuojë në hartimin e planit zhvillimor të arsimit nga komuna në rastet, kur ka të bëjë me shkollën përkatëse;

11.10. të ushtrojë funksionet e tjera që i janë deleguar nga komuna në pajtim me ligjin;

12. Këshilli drejtues mban dokumentacionin e duhur për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet. dhe sipas kërkesës i të në dispozicion për procedura të auditimit dhe inspektimit.

13. Këshilli drejtues i shkollës, me propozimin e drejtorit të shkollës, mund të themelojë organe të tjera këshilluese brenda shkollës.

14. Përfaqësuesit e nxënësve, në organet drejtuese të shkollës, nuk marrin pjesë në pjesët e takimit dhe diskutimet për çështjet që kanë të bëjnë me kushtet e punësimit apo çështjet personale të drejtorit, zëvendësdrejtorit, mësimdhënësve, punëtorëve tjerë të shkollës apo me çështje personale që kanë të bëjnë me nxënësit e tjerë.

15. Anëtari i Këshillit drejtues të shkollës nuk merr pjesë në pjesët e takimit dhe diskutimet për çështjet ku ai ka interes personal ose financiar dhe deklaron interesin e tillë në fillim të takimit.

16. Këshilli drejtues duhet të mbajë regjistrin e interesave personale dhe financiare të anëtarëve të tij dhe të personelit drejtues të shkollës.

11. Formulari

Emri i Monitoruesit:			
Organizata:	Këshilli i Nxënësve të Kosovë	Shkolla:	
Komuna:		Data:	
Anëtari i organit udhëheqës i intervistuar (Pozita e tij/saj)			

Nr.		Po	Jo
1.	A është mbledhur organi udhëheqës i shkollës suaj gjatë këtij viti shkollor Shtator 2015 - Janar 2016? Nëse po, sa herë është mbledhur dhe kur?_____ Nëse jo, pse nuk është mbledhur? _____ 1.1 Kush e thërret Këshillin Drejtues të Shkollës suaj dhe a janë të obliguara shkollat vetë ta thërrasin atë? _____ 1.2 Kush e menaxhon shkollën në rast të mosfunksionimit të Këshillit të Shkollës?_____ (Në rast të përgjigjes Jo, ndaloni këtu dhe përfundoni intervistën)		
2.	A ka procesverbal të takimit të mbajtur? (Në rast të përgjigjes Po, siguroni një kopje të mbledhjes së fundit)		
3.	A ka dokument tjetër që vërteton mbajtjen e takimit të Këshillit Drejtues të Shkollës?		
4.	A ka marrë pjesë përfaqësuesi i nxënësve në takimet e deritanishme të Këshillit Drejtues? 4.1 Cilat janë temat e ngritura nga përfaqësuesi i nxënësve në këto takime? a) _____, b) _____, c) _____.		
5.	Si është zgjedhur Këshilli i Nxënësve në shkollën tuaj? _____.		
6.	Sa është numri i nxënësve në shkollën tuaj? _____.		
7.	A marrin pjesë përfaqësuesit e prindërve në takim? Nëse Po, si janë zgjedhur këta përfaqësues? _____. 7.1 Cilat janë temat e ngritura nga përfaqësuesit e prindërve në këto takime? a) _____, b) _____, c) _____.		
8.	A ka marrë pjesë edhe dikush tjetër në takimet e deritanishme? Nëse Po, kush ka marrë pjesë? _____		
9.	A ka nxënës të komuniteteve në shkollën tuaj? (Nëse Po, atëherë vlen pyetja e 10të. Nëse Jo, atëherë kaloni pyetjen e 10të)		
10.	A ka përfaqësues të komuniteteve në kuadër të prindërve në Këshillin Drejtues?		
11.	A është ftuar ndonjëherë ndonjë përfaqësues i Drejtorisë Komunale të Arsimit në takime?		

Nr.		Po	Jo
12.	A e ka vizituar ndonjëherë shkollën tuaj ndonjë zyrtar i Inspektoratit të Arsimit të Kosovës?		
13.	A është marrë ndonjë vendim nga Këshilli Drejtues i Shkollës deri më tani? Nëse Po, cila ka qenë vendimi i fundit që ka marrë ky organ udhëheqës? _____. (Nëse Po, vlen pyetja e 14të. Nëse Jo, kaloni pyetjen e 14të)		
14.	Në takimet e deritanishme, a është marrë ndonjë vendim mbi nxënësit? Nëse Po, cilat janë vendimet e marra për nxënësit dhe si ka qenë procedura? _____.		
15.	A është diskutuar për fondet e shkollës?		
16.	A është diskutuar për aktivitetet shtesë jashtë plan programit shkollor?		
17.	A është diskutuar veshmbathja/uniforma në shkollë?		
18.	A është diskutuar për tekstet mësimore?		
19.	A është diskutuar për Këshillin e Nxënësve?		
20.	A ka shkolla juaj regjistër të interesave personale dhe financiare të anëtarëve të tij dhe stafit drejtues të shkollës suaj?		
21.	Lista e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Shkollës suaj? 1. _____ (prind), 2. _____ (prind), 3. _____ (prind), 4. _____ (nxënës), 5. _____ (mësimdhënës), 6. _____ (mësimdhënës), 7. _____ (mësimdhënës), 8. _____ (palët e interesit), 9. _____ (palët e interesit). vlen për shkollat me më shumë se 1000 nxënës: 10. _____ (prind), 11. _____ (nxënës), 12. _____ (mësimdhënës), 13. _____ (palët e interesit).		